

Luan Hasneziri



GJYQATAR NË GJYKATËN E SHKALLËS
SË PARË PËR KRIMET E RËNDA


Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017

Ndryshimi i Pasurisë ndër Vite



Pasuria para fillimit të detyrës është 0;
Pasuria bruto deri me datë 31.12.2017
është 9,930,000 lekë

+ 709,286 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë

Likuiditete
në Bankë

150,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

Likuiditete
në Cash

3,880,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

Pasuritë e
Paluajtshme

5,900,000

Para Fillimit të Detyrës Datë 31/12/2017

Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Paga dhe shpërblime nga funksioni	17,901,916	80.54%
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1,797,224	8.09%
Mësimdhënia	2,029,446	9.13%
Të ardhura nga shitja e librave	500,000	2.25%
Total	22,228,586	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

2 Me probleme
12 Pa Probleme

Subjekti Luan Hasneziri, nga kontrolli aritmetik dhe logjik rezultoi me pasuri të pajustificuar për dy vite, konkretisht në vitin 2008 nuk justifikon me burime shtesën prej 704,518 lekë dhe në vitin 2010 shumën 68,852 lekë - në këtë analizë nuk janë llogaritur shpenzimet e konsumit familjar. Në vitin 2006 subjekti ka deklaruar një hua në shumën 5,900,000 lekë për blerje apartamenti, të shlyer brenda vitit në shumën 4,900,000 lekë nëpërmjet një kredie bankare, ndërsa diferenca është shlyer me këste deri në fund të vitit 2014. Gjendja Cash me datë 31.12.2017 është 3,880,000 lekë, ndërkohë që sipas nenit 4/1 të ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë" i ndryshuar, kufiri i lejuar për t'u mbajtur Cash është 1,500,000 lekë. Në vitin 2014 subjekti ka deklaruar detyrim financiar me kontratë huamarrje në shumën 40,000 usd si garanci për marrjen e vizes nga Ambasada e Sheteve te Bashkuara te Amerikes - shuma është kthyer brenda vitit per shkak te refuzimi te vizes.